



FAKULTETI I EDUKIMIT

PLANI STRATEGJIK

2024-2028

FAKULTETI I EDUKIMIT

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Rr. Shkronjave 1, 20000 Prizren

Republika e Kosovës



FAKULTETI I EDUKIMIT
Plani Strategjik
2024-2028



SHKURTESAT

UUHP	Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
PSAK	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë
SHU	Shoqata e Universiteteve
MM	Memorandum Mirëkuptimi
BE	Bashkimi Evropian
ZBN	Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar
ZIK	Zyra për Zhvillim të Cilësisë
QKA	Qendra e Karrierës dhe Alumni
BKI	Bordi Këshillëdhënës Industrial
TI	Teknologjia e Informacionit
USAID	Ndihma e SHBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar
MASHT	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
KSHC	Këshilli Shtetëror i Cilësisë
PS	Parlamenti Studentor
NJA	Njësitë Akademike

PËRMBAJTJA

Fjala e dekanit

Historiku i Fakultetit të Edukimit

1. Themelet e planit strategjik

- 1.1. Misioni
- 1.2. Vizioni
- 1.3. Vlerat
- 1.4. Grupet e interesit

2. Procesi i planifikimit strategjik

- 2.2. SWOT Analiza

3. Prioritetet strategjike

1. Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie
2. Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore
3. Kontributi në komunitet
4. Procesi i ndërkombëtarizimit dhe rrjetëzimit
5. Zhvillimi i infrastrukturës

4. Plani i veprimit



FJALA E DEKANIT

Prof. Asoc. Dr. Vedat Bajrami

Fakulteti i Edukimit, si pjesë përbërëse e Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, ka hartuar planin strategjik, i cili përcakton prioritetet e matshëm, për zhvillimin e mëtejshëm, për të kontribuar në zhvillimin e Universitetit në tërësi.

Me qëllim të ruajtjes së prestigjit, lider i arsimit të lartë, në fushën e arsimit fillor dhe të edukimit të hershëm/parashkollor, Fakulteti ka përcaktuar prioritetet e tij strategjike, që kanë të bëjnë me të gjitha aktivitetet e tij, veçanërisht me: mësimdhënien, kërkimin shkencor, transferimin e njohurive dhe përfshirjen rajonale, ndërkombëtarizimin dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.

Plani strategjik, në kuadër të prioritetëve strategjike bazohen në:

- Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë, në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG) dhe Standardet e Vlerësimit, të bazuara në komponentët universitarë, në procesin e riakreditimit të institucioneve të arsimit të lartë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim;

- Politikat e mëparshme strategjike të Universitetit dhe të Fakultetit, të cilat shprehin orientimin e stafit akademik dhe administrativ të Fakultetit, drejt promovimit të vazhdueshëm të nivelit të lartë, të standardeve cilësore të punës studimore, shkencore dhe profesionale.

Fakulteti i Edukimit angazhohet në:

- Zhvillimin e vazhdueshëm të cilësisë së studimeve, bazuar në standardet dhe udhëzimet evropiane, kriteret kombëtare dhe universitare dhe standardet e cilësisë, me aktivitete duke inkurajuar rolin e të gjitha palëve të interesuara;

- Zhvillimin e programeve të studimit bazuar në rezultatet e kërkimeve më të fundit shkencore, të cilat rezultojnë në një nivel të lartë të rezultateve të të nxëniet të arritura në fushën e arsimit të hershëm/parashkollor dhe arsimit fillor,

- Sigurimin e ndershmërisë akademike, etikës, përgjegjësisë dhe mundësive të barabarta për stafin akademik dhe studentët;

- Monitorimin e vazhdueshëm dhe përmirësimi sistematik i efektivitetit të veprimtarive arsimore, shkencore dhe profesionale;

- Aktivitetet të përgjegjshme dhe transparente që synojnë zhvillimin e Fakultetit.

Monitorimi i vazhdueshëm i arritjes së objektivave dhe zbatimi i aktiviteteve të përcaktuara në Plan strategjik është parakusht për vlerësimin e nivelit të arritur të cilësisë në Fakultet.

HARTIMI I PLANIT STRATEGJIK*

Ky plan strategjik është hartuar në bazë të vendimit të Këshillit të Fakultetit me Ref. 01-581, datë 18.12.2023.

Plani Strategjik 2024-2028 është hartuar pas konsultimeve intensive dhe gjithëpërfshirëse të akterëve të brendshëm dhe të jashtëm të UUHP. Të gjitha aktivitetet zhvillimore të Fakultetit të Edukimit do të mbështetën dhe udhëhiqen nga ky Plan strategjik.

*Plani strategjik i Fakultetit të Edukimit do të rishikohet pas hartimit të planit strategjik të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren.

Anëtarët e komisionit të hartimit të planit strategjik

Prof. Ass. Dr. Artan Reshani, kryetar
Prof. Asoc. Dr. Elsev Brina Lopar, anëtare
Prof. Asoc. Dr. Ajka Alilji, anëtare
Prof. Asoc. Dr. Shemsi Morina, anëtar
Prof. Ass. Dr. Jasmin Jusufi, anëtar
Prof. Ass. Dr. Fatmir Mehmeti, anëtar
Prof. Asoc. Dr. Munevver Muyo Yildirim, anëtare
Prof. Ass. Dr. Gjylë Totaj Salihu, anëtare
Msc. Hilmi Rexhaj, anëtar – përfaqësues i BKI-së
Arbresha Rexhbeqaj, anëtare (përfaqësues i studentëve)

HISTORIKU I FAKULTETIT TË EDUKIMIT

Fakulteti i Edukimit në UUHP, traditën dhe reputacionin e ndërtoi qysh prej vitit 1962. Në vitin shkollor 1962/63 u hapën edhe 4 degë të reja mësimi: Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze, Dega e Matematikës me Fizikën, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Turke, Dega e Gjuhës dhe Letërsisë Ruse.

Në vitin 2001, Senati i Universitetit të Prishtinës miratoi planet mësimore të mbështetura në Deklaratën e Bolonjës, për nivelin Baçelor. Pas themelimit të Fakultetit të Edukimit, nga viti shkollor 2002/2003, nuk regjistrohen studentë në programet e SHLP-së, fillimisht vetëm në degën e Mësimit Klasor, ndërsa më vonë edhe në programet e tjera.

Në vitin akademik 2004/2005, në Shkollën e Lartë Pedagogjike të Prizrenit ligjëratat i përcjellin 436 studentë, të regjistruar më herët, ndërsa në procesin mësimor qenë të angazhuar 9 mësimdhënës dhe arsimtarë në marrëdhënie të rregullt pune dhe 16 në punë plotësuese dhe të angazhuar.

Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren (UUHP) është themeluar më 09.10.2009 me vendimin numër 01/87, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, ndërsa pas një pune intensive përgatitore me konsulentë ndërkombëtarë ka nisur punën më 2010. Selia e Universitetit të Prizrenit është në Prizren. Tradita universitare fillon shumë më herët, me Shkollën e Lartë Pedagogjike (SHLP) në Prizren, në vitin 1962, që ishte guri i parë themeltar i këtij Universiteti. SHLP ishte bërë e pavarur nga Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë i cili ishte institucioni i parë i arsimit të lartë në Kosovë. SHLP në Prizren më vonë është shndërruar në Fakultetin e Edukimit-Dega në Prizren, në kuadër të Universitetit të Prishtinës. Dega e Fakultetit të Edukimit në Prizren nga viti 2010/2011 kalon në kuadër të Universitetit të Prizrenit. Në Programin Fillor, Programin Parashkollor dhe Programin Matematikë-Informatikë në këtë Fakultet, mësimi organizohej edhe në gjuhën turke përkatësisht në atë boshnjake. E njëjta traditë ka vazhduar edhe me Universitetin e Prizrenit.

1. THEMELET E PLANIT STRATEGJIK

Ky plan strategjik është hartuar në fund të vitit 2023, të cilin plan Fakulteti i Edukimit, i Universitetin “Ukshin Hoti”, në Prizren do të përdor si dokumenti bazë për zhvillimin e periudhës pesë vjeçare 2024-2028. Procesi i zhvillimit të këtij dokumenti filloi në fund të vitit 2023, kur u formua struktura organizative, për hartimin e planit strategjik e përbërë nga një nëngrup i Njesisë akademike, përkatësisht nga Fakulteti i Edukimit. Vlerësimi përmes SWOT analizës dhe analizës së RVV, ka qenë bazë për planifikimin strategjik pesë vjeçar.

- Planin strategjik është përgatitur prej: personeli akademik, shërbimet profesionale dhe administrative, përfaqësuesin e studentëve etj.
- Gjatë hartimit të planit strategjik, grupi punues ka shqyrtuar analizat, raportet e RVV-së, si bazë e punës duke i përfshirë rekomandimet e Agjencisë Kosovare për Akreditim.

Procesi i planifikimit ka kaluar nëpër faza të caktuara. Përgatitja e planifikimit strategjik e iniciuar nga UUHP, Dekanati i Fakultetit të Edukimit (Dekani, Shefat e Departamenteve në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake, Sekretari si dhe personeli akademik), duke identifikuar arsyet dhe shkaqet për planifikimin strategjik si dhe

pikat fillestare. Analiza, artikulimi dhe përcaktimi i objektivave, aktiviteteve, masave, identifikimi i treguesve të suksesit (indikatoreve) dhe përcaktimi i masave zbatuese.

1.1. Misioni

Fakulteti i Edukimit ka mision të përgatisë gjenerata të reja të mësimdhënësve dhe edukatorëve, të cilët do të jenë të angazhuar në mësimdhënie cilësore, kërkim shkencor dhe shërbim ndaj komunitetit, duke inkurajuar inovacionin, krijimtarinë, përsosmërinë e stafit akademik dhe të studentëve si dhe duke synuar të jetë një pikë referimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

1.2. Vizioni

Fakulteti synon të jetë një model i përsosur në zhvillimin e arsimit, duke krijuar një rrjet të fortë bashkëpunimi me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke kontribuar në jetën arsimore, shkencore, sociale dhe kulturore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Po ashtu, fakulteti do të jetë konkurrent në fushën edukative dhe shkencore, duke krijuar një mjedis të pasur të kërkimit dhe zhvillimit shkencor.

1.3. Vlerat

Fakulteti i Edukimit promovon vlera si në vijim:

Liria akademike, garantojmë lirinë e të shprehurit, hulumtimit dhe transmetimit të informacionit.

Barazia, respektojmë diversitetin, pikëpamjet dhe kontributet e të tjerëve. I trajtojmë të gjithë të barabartë.

Përgjegjësia, marrim përgjegjësi për vendime dhe rezultate. Monitorojmë dhe rishikojmë performancën për të nxitur përmirësimin.

Besimi dhe transparencia, ndërtojmë marrëdhënie bazuar në transparencë, ndershmëri dhe respekt të ndërsjellë.

Integriteti, veprojmë profesionalisht me ndershmëri dhe qëndrueshmëri. Jemi transparentë me informacionet dhe vendimet tona.

Përsosmëria, pritshmëritë tona janë të mëdha dhe vazhdimisht kërkojmë të përmirësojmë institucionin dhe punën tonë. Jemi të hapur dhe mirëpresim bashkëpunimin me të tjerët.

Shërbimi, jemi fleksibël, inovues, të përgjegjshëm dhe të besueshëm. Ofrojmë shërbime të koordinuara dhe të harmonizuara për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënit.

Angazhimi ndaj vlerave etike, njëra nga vlerat tona thelbësore për të vepruar në përputhje me parimet e ligjshmërisë, drejtësisë, barazisë, ndershmërisë dhe përgjegjshmërisë ndërsa përmbushim misionin tonë.

Demokracia, princip kryesor dhe universal i Fakultetit të Edukimit.

1.4. Palët e interesit

Fakulteti i Edukimit e planifikon zhvillimin e tij strategjik, për periudhën 2024-2028, duke u mbështetur në bashkëpunimin dhe ndërveprimin e ngushtë me palë e interesit, të cilët janë aktiv brenda dhe jashtë mjedisit të Fakultetit të Edukimit.

Palët e brendshme të interesit:

STAFI AKADEMIK

Stafi akademik përbënë bartësit kryesorë të procesit edukativ dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore. Ky grup i interesit përfaqësohet nga profesorët e rregullt, profesorët e angazhuar, asistentët dhe bashkëpunëtorët shkencor. Stafi akademik i rregullt kategorizohet sipas thirrjes akademike në Prof. Asoc. Dr., Prof. Ass. Dr. dhe Ass.

STAFI ADMINISTRATIV DHE TEKNIK

Stafi administrativ dhe teknik përbëjnë palët e brendshme të interesit, të cilët kryejnë funksionet operative dhe teknike të FE.

- Sekretari
- Zyrtarët për shërbime studentore (Baçelor dhe Mastër)
- Bibliotekari
- Personeli teknik

MENAXHMENTI I FAKULTETIT TË EDUKIMIT

Menaxhmenti i Fakultetit të Edukimit përbën organet udhëheqëse, që përkujdesen për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e procesit të mësimdhënies, punës kërkimore-shkencore, zhvillimit profesional të mësimdhënësve, konferencave shkencore, simpoziumeve, etj..

- Dekani
- Prodekani
- Këshilli i Fakultetit
- Këshilli i Cilësisë

Palët e jashtme të interesit:

STUDENTËT

Studentët janë përfituesit kryesor të procesit të përvetësimit dhe transferit të dijes funksionale. Këtë grup të interesit e përbëjnë studentët e rregullt vendorë dhe ata ndërkombëtarë.

ALUMNI (STUDENTËT E DIPLOMUAR)

Alumni janë studentët e diplomuar, të cilët vazhdojnë t'i gëzojnë shërbimet e Fakultetit të Edukimit si dhe të kontribuojnë në lidhjen e urave të komunikimit të Fakultetit me komunitetin e jashtëm. Ky grup i interesit mund të krijojë komunitetin e vet pas përfundimit të studimeve.

KOMUNITETI

Komuniteti është palë strategjike e interesit e cila përbëhet nga Institucionet shkollore, Drejtoritë Komunale të Arsimit, Institutet hulumtuese, MAShT, Institucionet parashkollore dhe shkollore (publiko-private dhe private), OJQ-të dhe shoqëria civile.

AUTORITETI QEVERITAR LOKAL DHE QENDROR

Autoriteti qeveritar, në nivel lokal dhe qendror, është akter i rëndësishëm në zbatimin e Planit strategjik. Në këtë kuadër përfshihen përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, DKA-së, institucionet shkollore, etj..

KOMUNITETI I JASHTËM AKADEMIK DHE SHKENCOR

Komuniteti i jashtëm akademik dhe shkencor përbëhet nga partnerët e jashtëm strategjik, duke përfshirë institucionet shkollore, institutet hulumtuese, bashkëpunimit mes fakulteteve të edukimit, bashkëpunimin ndërkombëtarë me Fakultetin e Edukimit.

Statistika të përmblhedhura

Statistika të përmblhedhura

Numri i studentëve të regjistruar nga viti 2020

2020/21	2021/22	2022/23	2023/24
280	148	126	141

Numri i punimeve shkencore të stafit akademik

2021	2022	2023
16	17	13

Struktura gjinore e studentëve

2020/21		2021/22		2022/23		2023/24	
F	M	F	M	F	M	F	M
120	32	122	26	114	12	135	6

Personeli akademik i rregullt

Profesor i asocuar	Profesor asistent
10	8

Studentët e diplomuar sipas gjinisë

2019/20		2020/21		2021/22		2022/23	
F	M	F	M	F	M	F	M
209	22	330	27	257	18	121	10

2. PROCESI I PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

Procesi i rishikimit dhe hartimit të këtij dokumenti filloi në fund të vitit 2023, kur u formua Grupi Punues si strukturë organizative për hartimin e planit strategjik.

2.1. PRIORITETET STRATEGJIKE

- Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie
- Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore
- Fuqizimi i partneritetit në komunitet
- Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rrjetëzimit
- Përmirësimi i infrastrukturës dhe dixhitalizimi

PRIORITETI STRATEGJIK 1
Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie/mësimnxënie

PRIORITETI STRATEGJIK 2
Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore

PRIORITETI STRATEGJIK 3
Fuqizimi i partneritetit në komunitet

PRIORITETI STRATEGJIK 4
Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të rrjetëzimit

PRIORITETI STRATEGJIK 5
Përmirësimi i infrastrukturës dhe dixhitalizimi

Fuqitë

- Kulturë dhe traditë institucionale
- Përvojë në organizimin e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare
- Staf akademik profesional i përkushtuar për punë kërkimore e hulumtuese
- Programet e studimeve në gjuhët e etnive kombëtare
- Respektimi i diversitetit etnik, kulturor dhe fetar i studentëve
- Programet studiuose atraktive të ndërlidhura me tregun e punës
- Internacionalizi i programeve studiuose
- Staf akademik nga Universitetet e njohura të rajonit

- Rrjetëzimi me fakultetet e Edukimit, në nivel Kombëtar dhe Ndërkombëtar
- Promovimi përmes traditës kulturore, historike dhe diversitare
- Avancimi dhe ridizajnimi i praktikës pedagogjike me institucione shkollore publike dhe private
- Shfrytëzimi i resurseve të Qendrës për kërkime dhe hulumtime
- Hartimi dhe akreditimi i programeve për trajnimin e mësimitdhënësve
- Hapja e programeve studimore në nivelin Master
- Konkurrimi në programet e ERASMUS Plus për mobilitet dhe zhvillim të mësimitdhënësve.

Mundësitë

Dobësitë

- Numri i kufizuar i programeve studimore
- Mungesa e niveleve të studimit Master dhe Doktoratë
- Mobiliteti i kufizuar i stafit akademik dhe i studentëve.
- Mbështetja e pamjaftueshme financiare për punën hulumtuese dhe kërkimore.
- Pamundësia e publikimeve shkencore në revista dhe platforma të rekomanduara
- Mungesa e infrastrukturës dhe pajisjeve për mësimitdhënie dhe mësimitdhënie bashkëkohore
- Kufizimi në rekrutimin e stafit akademik

- Kufizimet buxhetore të financimit të projekteve
- Avancimi i stafit në tituj akademik për nivelet e caktuara të studimeve

Rreziqet

3.PRIORITETET STRATEGJIKE

1. Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik, Fakulteti i Edukimit ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- Objektivi strategjik 1: Vlerësimi dhe kontrolli i cilësisë në procesin e edukimit;
- Objektivi strategjik 2: Përmirësimi i strukturës dhe përmbajtjes së programeve studiuës;
- Objektivi strategjik 3: Avancimi i metodave bashkëkohore në mësimdhënie;
- Objektivi strategjik 4: Fuqizimi i programeve dhe hapja e programeve të reja studiuëse.

2. Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti i Edukimit ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- Objektivi strategjik 1: Avancimi i infrastrukturës, zgjerimi i mjediseve për punë hulumtuëse në Fakultetin e Edukimit;
- Objektivi strategjik 2: Përkrahja e stafit për pjesëmarrje në organizime kombëtare e ndërkombëtare;
- Objektivi strategjik 3: Ngritja e sistemit planifikues për punën hulumtuëse dhe shkencore;
- Objektivi strategjik 4: Organizimi i konferencave ndërkombëtare në shkencat e Edukimit

3. Fuqizimi i partneritetit në komunitet

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti i Edukimit ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- Objektivi strategjik 1: Ndërtimi i partneriteteve me institucione arsimore qeveritare dhe joqeveritare si dhe me shoqërinë civile;
- Objektivi strategjik 2: Ofrimi i këshillave profesionale për palët e interesit;
- Objektivi strategjik 3: Inkuadrimi i studentëve në projekte dhe aktivitete komunitare.

4. Thellim i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të rrjetëzimit

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti i Edukimit ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- Objektivi strategjik 1: Zhvillimi i kapaciteteve profesionale për zbatimin e projekteve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar;
- Objektivi strategjik 2: Bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë brenda Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).
- Objektivi strategjik 4: Shkëmbimi i stafit akademik dhe të studentëve me universitetet ndërkombëtare.

5. Përmirësimi i infrastrukturës dhe dixhitalizimi

Në kuadër të këtij prioriteti strategjik Fakulteti i Edukimit ka përcaktuar këto objektiva strategjike:

- Objektivi strategjik 1: Investime në teknologjinë mësimore;
- Objektivi strategjik 2: Përmirësimi i aftësive të stafit akademik në përdorimin e TIK;
- Objektivi strategjik 3: Funkcionalizimi i plotë i qasjes në internet.

Kampusi i UUHP

FAKULTETI I EDUKIMIT



BIBLIOTEKA E UNIVERSITETIT



FJALOR I PËRMBLEDHUR

Procesi i Bolonjës (Bologna Process / Bologna-Prozess) është një seri e takimeve ndërministrare dhe marrëveshjeve midis vendeve evropiane të dizajnuara, për të siguruar krahasueshmërinë e standardeve dhe cilësisë së kualifikimeve të arsimit të lartë. Përmes **Marrëveshjeve të Bolonjës**, procesi ka krijuar Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, në veçanti nën Konventën e Lisbonës. Ajo është emëruar sipas vendit ku ishte propozuar, Universiteti i Bolonjës, me nënshkrimin e Deklaratës së Bolonjës, nga ana e Ministrave të Arsimit të 29 shteteve të Evropës. Në vitin 1999, duke krijuar një pjesë të integritimit evropian.

Procesi i Akreditimit (Accreditation process /Akkreditierungsprozess) është vlerësimi i cilësisë në institucionet publike dhe private të arsimit të lartë. Përmes procesit të akreditimit përkrah zhvillimin e cilësisë, në këto institucione që institucioni i arsimit të lartë të përmbush kriteret e pranueshme të cilësisë.

Sistemi evropian për grumbullim dhe transfer të kredive (ECTS – European Credit Transfer and Accumulation System / ECTS – Europäisches System zur Übertragung und

Akkumulierung von Leistungspunkten) është një standard për krahasimin e arritjeve në studime dhe për performancë të studentëve të arsimit të lartë, në Bashkimin Evropian dhe i vendeve të tjera evropiane, që bashkëpunojnë në këtë fushë. Për studimet, ECTS kreditë jepen pas përfundimit me sukses të studimit. Një vit akademik korrespondon me 60 **ECTS-kredi**, që janë ekuivalente me 1500–1800 orë studimi në të gjitha vendet, pa pasur parasysh standardin ose llojin e kualifikimit dhe përdoret për ta lehtësuar transferin dhe avancimin nëpër tërë Bashkimin Evropian.

Koriza Evropiane e Kualifikimeve – KEK (European Qualifications Framework, EQF / Europäische Qualifikationsrahmen für lebenslanges Lernen EQR) Korniza e kualifikimeve i klasifikon kualifikimet sipas një ser kriteresh për nivele të specifikuar **të mësuarit e të arritura**. Ajo synon të integrojë dhe koordinojë kualifikimet, si edhe të përmirësojë transparencën, aksesueshmërinë dhe cilësinë e kualifikimeve në lidhje me tregun e punës, sistemin e arsimit dhe të formimit, si dhe shoqërinë civile. Kornizat e kualifikimeve mbështesin të mësuarit gjatë të gjithë jetës (pra, të gjitha aktivitetet e të mësuarit që zhvillohen gjatë jetës), me synimin e përmirësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave brenda një perspektive personale,

civile, shoqërore dhe/ose të lidhur me punësimin. Ky përkufizim mbulon gamën e plotë të të mësuarit zyrtar, jozyrtar dhe informal.

Projekti Tuning – (Tuning project/ Tuning-Projekt)

Projekti Tuning prej vitit 2001, mbështetet në kuadër të programeve SOCRATES, ERASMUS nga Komisioni Europian. Është një projekt, për harmonizimin e strukturave arsimore në Evropë, i nisur nga universitetet, i cili mëton të ofrojë një qasje konkrete për zbatimin e Procesit të Bolonjës, në nivel të institucioneve të arsimit të lartë dhe të fushave lëndore.

Zona Evropiane e Arsimit të Lartë - European Higher Education

Area – **EHEA** / Europäischer Hochschulraum (EHR) filloi si një iniciativë e përbashkët e përvjetorit të "Procesit të Bolonjës", në Mars të vitit 2010, gjatë Konferencës Ministrore Budapest - Vjenë. Si objekt kryesor i Procesit të Bolonjës, që prej fillimit të saj, në vitin 1999, EHEA ishte menduar të siguronte sisteme të krahasueshme, kompatible dhe koherente të arsimit të lartë në Evropë. Mes viteve 1999 - 2010, të gjitha përpjekjet e anëtarëve të Procesit të Bolonjës ishin të përqendruar në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, e cila u bë realitet me Deklaratën e Marsit të vitit 2010. në Budapest - Vjenë.

Mobiliteti (Mobility / Mobilität)

Sigurimi i cilësisë (Quality assurance / Qualitätssicherung)

Ngarkesa e punës - Workload / Arbeitsbelastung

ENQA – European Association for Quality Assurance in Higher Education.

EUA – European University Association.

ENIC Network/NARIC Network European Network of National Information Centres/Network of National Academic Recognition Information Centres.

European Research Area (ERA) / Europäischer Forschungsraum (EFR).

Burimet

1. Plani Strategjik i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren 2020 – 2024
2. Plani Strategjik i Fakultetit të Edukimit 2020 - 2023
3. Glossary on the Bologna Process English – German – Russian. Beiträge zur Hochschulpolitik 7/2006. Bonn 2006.
https://www.hrk.de/fileadmin/redaktion/hrk/02-Dokumente/02-10-Publikationsdatenbank/Beitr-2006-07_Glossary_Bologna.pdf
4. Korniza Evropiane e Kualifikimeve -
https://ec.europa.eu/ploteus/sites/eac-efq/files/efq_interactive_brochure_sq_0.pdf
5. Korniza e kualifikimeve për mësimin gjatë gjithë jetës
https://akkks.rks-gov.net/uploads/korniza_evropiane_e_kualifikimeve.pdf
6. Strategjia e Arsimit 2022-2026
<https://masht.rks-gov.net/strategjia-e-arsimit-2022-2026plani-i-veprimit/>



PLANI I VEPRIMIT

Nr.	Objektivit strategjik	Aktivitetet	Masat	Bartësit	Afati kohorë	Kostoja (Euro)
Prioriteti strategjik 1: Sigurimi i cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie						
1.	Vlerësimi dhe kontrolli i cilësisë në procesin e edukimit.	- Realizimi i anketave me studentë, monitorimi i mësimdhënies.	- Vendosija e standardeve për formën dhe mënyrën e anketimit dhe përpilimi i raporteve me rezultate; - Monitorimi i mbarëvajtjes së mësimit disa herë brenda semestrit.	- Dekani, prodekani dhe stafi administrativ; - Komisioni për sigurimin e cilësisë brenda Fakultetit të Edukimit.	2024-2028	0,000
2.	Përmirësimi i strukturës dhe përmbajtjes së programeve studiuuese.	- Rishikimi i përmbajtjeve të programeve studiuuese; - Rishikimi i syllabusëve; - Analiza e vlerësimeve nga procesi i vlerësimit semestral; - Nxjerrja e rekomandimeve për përmirësimin e strukturës dhe përmbajtjeve të programeve studimore.	- Formimi i grupeve për rishikimin e përmbajtjeve dhe syllabusëve - Përkrahja administrative për Grupin punues - Bashkëpunimi me Komisionin e Sigurimit të Cilësisë në nivel Fakulteti dhe Universiteti	Komisionet për rishikimin e përmbajtjes së programeve studiuuese.	2024-2028	0,000
3.	Avancimi i metodave bashkëkohore në mësimdhënie.	- Trajnimi i stafit akademik në implementimin e	- Bashkëpunimi me Qendrën për	UUHP, Fakulteti i Edukimit	2024-2028	5,000

		metodologjive (strategjive, metodave, teknikave) bashkëkohore.	Përsosmëri në Mësimdhënie; - Pjesëmarrja në projekte të avancimit të vazhdueshëm profesional në karrierë.			
4.	Fuqizimi i programeve dhe hapja e programeve të reja studiuese.	Përshtatja e programit Parashkollor, sipas trendëve zhvillimore në “Edukimi, në fëmijërinë e hershme (0-6 vjet)”; Hapja e programit studimor Master në Shkencat e Edukimit me specializim: Mësimdhënie dhe Kurrikulë.	- Përgatitja dhe aprovimi i studimit të fizibilitetit; - Hartimi i RVV-ve dhe aplikimi për akreditim në AKA.	Stafi akademik, Këshilli i Fakultetit të Edukimit, bartësit e programeve, Senati, Këshilli Drejtues i Universitetit.	2024-2025 2024-2028	0,000
- Prioriteti strategjik 2: Zhvillimi i punës kërkimore-shkencore						
1.	Avancimi i infrastrukturës, zgjerimi i mjediseve për punë hulumtuese në Fakultetin e Edukimit.	- Furnizimi i sallës me kompjuterë dhe softuer të licencuar (IBM SPSS, RStudio, MAXQDA, NVIVO apo Atlas.it); - Trajnimi i mësimdhënësve lidhur me metodologjitë hulumtuese dhe për përdorimin e softuerëve të licencuar për të analizuar të dhënat;	- Inkurajimi i stafit akademik për të ndjekur trajnimet lidhur me metodologjitë dhe përdorimin e softuerëve.	UUHP Fakulteti i Edukimit Stafi Akademik Qendra për inovacion, transfer dhe kërkim të dijes.	2024-2028	10,000
2.	Përkrahja e stafit për pjesëmarrje në organizime kombëtare e ndërkombëtare.		- Inkurajimi i stafit akademik për zhvillim	UUHP	2024-2028	15,000

		Aplikimi për përkrahje nga institucionet vendore (MASHTI) dhe partnerët ndërkombëtar në projekte të përbashkëta.	të vazhdueshëm profesional dhe shkencor - Inkurajimi i stafit për të paraqitur punime shkencore në konferenca ndërkombëtare dhe aktivitete të ngjashme.	Këshilli i Fakulteti të Edukimit, Këshilli i Cilësisë.		
3.	Ngritja e sistemit planifikues për punën hulumtuese dhe shkencore.	- Hartimi i planit të veprimit për punë hulumtuese dhe shkencore.	- Formimi i komisionit për hartimin e planit të veprimit.	Këshilli i Fakultetit të Edukimit, Këshilli i Cilësisë.	2024-2025	5,000
4.	Organizimi i konferencave ndërkombëtare në shkencat e Edukimit	- Mbajtja e konferencave shkencore në fushën e edukimit	- Formimi i Këshillit Organizativ - Bashkëpunimi me partnerë kombëtar dhe ndërkombëtar	UUHP, Senati, Fakulteti i Edukimit	2024-2028	10,000
Prioriteti strategjik 3: Fuqizimi i partneritetit në komunitet						
1.	Ndërtimi i partneriteteve me institucione arsimore qeveritare dhe joqeveritare dhe me shoqërinë civile.	Lidhja e marrëveshjeve dhe krijimi i planifikimeve me institucionet arsimore dhe me OJQ.	- Takimet me MASHT, DKA, institucione shkollore dhe parashkollore (publike dhe private), OJQ, shoqëri civile.	Fakulteti i Edukimit	2024-2028	0,000
2.	Ofrimi i këshillave profesionale për palët e interesit.	- Zbatimi dhe realizimi i aktiviteteve profesionale dhe shkencore-hulumtuese.	- Dhënia dhe ofrimi i informacioneve, këshillave, rekomandimeve.	Fakulteti i Edukimit	2024-2028	0,000
3.	Inkuadrimi i studentëve në projekte dhe aktivitete në komunitet.	Identifikimi dhe bashkëpunimi me OJQ-të lokale - vendore dhe ndërkombëtare për zhvillimin e arsimit.	- Stafi Akademik dhe studentët pjesëmarrës aktiv në aktivitetet e organizuara në	Fakulteti i Edukimit	2024-2028	0,000

			bashkëpunim me OJQ-të.			
Prioriteti strategjik 4: Thellimi i bashkëpunimit ndërkombëtar dhe të rrjetëzimit						
1.	Zhvillimi i kapaciteteve profesionale për zbatimin e projekteve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.	<ul style="list-style-type: none"> - Trajnimi profesional i stafit akademik për informim, përgatitjen dhe hartimin e projekteve shkencore dhe ndërkombëtare . 	<ul style="list-style-type: none"> - Inkurajimi i stafit për pjesëmarrje në trajnime profesionale për përgatitjen dhe hartimin e projekteve shkencore. 	UUHP, Senati, FE	2024-2028	10,000
2.	Bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë brenda Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).	<ul style="list-style-type: none"> - Përgatitja e Planit të veprimit për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe mobilitet në zonën EHEA; - Përgatitja dhe zbatimi i programit të informimit dhe edukimit të personelit dhe studenteve mbi bazën e Planit të veprimit; - Lidhja e marrëveshjeve me institucione të arsimit të lartë brenda EHEA-së. 	<ul style="list-style-type: none"> - Formimi i grupit punues për hartimin e planin të veprimit; - Kontrollimi i web faqeve zyrtare të Institucioneve të arsimit të lartë brenda EHEA ; - Identifikimi i institucioneve të arsimit të lartë brenda EHEA-së, që kanë interes të përbashkët dhe vlera të ngjashme me fakultetin. 	UUHP, Fakulteti i Edukimit	2024-2028	0,000
3.	Shkëmbimi i stafit akademik dhe i studentëve me universitetet ndërkombëtare.	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i planit dinamik të veprimit për shkëmbim të stafit akademik dhe të studentëve. 	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e mësimit në mësimdhënësve në takimet edukative dhe informuese në FE e lidhur me 	UUHP, Fakulteti i Edukimit	2024-2028	5,000

			mobilitetin e studentëve.			
Prioriteti strategjik 5: Përmirësimi i infrastrukturës dhe dixhitalizimi						
1.	Investime në teknologjinë mësimore	<ul style="list-style-type: none"> - Sigurimi i teknologjisë së fundit në mësimdhënie dhe mësimnxënie (tabelat e mençura, materialet mësimore) për të përmirësuar përvojën akademike dhe për të përgatitur studentët për tregun e punës të dixhitalizuar. 	<ul style="list-style-type: none"> - Definimi i kërkesave - Mbajtja e trajnimeve bazike për përdorimin e mjeteve dhe materialeve teknologjike 	UUHP, Fakulteti i Edukimit, Donacionet	2024-2026	10,000
2.	Përmirësimi i aftësive të stafit akademik në përdorimin e TIK	<ul style="list-style-type: none"> - Ndjekja e trajnimeve dhe seminareve të specializuara për stafin akademik, për të ndihmuar në zhvillimin aftësive konkrete në përdorimin e mjeteve dhe teknologjive të ndryshme të TIK; - Krijimi i një programi mentorimi ku anëtarë të stafit akademik me njohuri më të mira në TIK do t'i ndihmojnë pjesën tjetër të stafit; 	Inkurajimi i stafit akademik, që të përfshihen në trajnime, seminare dhe projekte konkrete lidhur me përdorimin e teknologjisë, për të përmirësuar mësimdhënien.	Fakuleti i Edukimit	2024-2028	10,000

3	Funksionalizimi i plotë i qasjes në internet (nëpërmjet WI-Fi)	- Modernizimi i infrastrukturës teknologjike.	- Dixhitalizimi i objektit të Fakultetit me rrjet dhe aparatura të tjera përcjellëse.	UUHP, Fakulteti i Edukimit, Donacionet	2024-2026	15,000
---	--	---	---	--	-----------	--------